



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË PËR VITIN 2022

Raporti i nënshkruar nga

Vlora Spanca,

Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, maj 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të MSH kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Shëndetësisë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Shëndetësisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Shëndetësisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që

burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Shëndetësisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Ministria në vitin 2022 ka shpenzuar 65% të buxhetit final ose 35,744,066€. Në kontekst të sistemeve financiare fushat ku janë identifikuar mangësi më të theksuara ishin te shpenzimet që kanë të bëjnë me klasifikimin jo adekuat, menaxhimin e proceseve financiare dhe të prokurimit, si dhe në menaxhimin dhe kompensimin e specialistëve. Me tutje, pasuritë nuk ishin regjistruar siç kërkohet në regjistrat kontabël dhe si rezultat kemi nënvlerësim/mbivlerësim të pasurive.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime, prej tyre katër (4) janë rekomandime të reja, dy (2) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 11,695,067€, i cili ishte shpenzuar 92%. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 1281, ndërsa në fund të vitit pozita aktuale të të punësuarve ishin 1,051. Gjatë vitit 2022 nuk kishte rekrutime.

Çështja B1 - Mangësi në menaxhimin e specialistëve

Gjetja

Sipas nenit 49 të Ligjit të Punës nr.03/L-2012, femra e punësuar ka të drejtën e pushimit të lehonisë deri në një vit. Gjashtë (6) muajt e parë pagesa bëhet nga punëdhënësi, tre (3) muaj nga Qeveria dhe tre (3) muajt e fundit pushimi i lehonisë është pa pagesë. Për të përfituar të drejtën e kompenzimit për tre (3) muaj nga Qeveria sipas nenit 5 të UA nr. 01/2018, e punësuar duhet të plotësoj formularin zyrtar dhe t'ia bashkangjes edhe Vendimin e lëshuar nga punëdhënësi për shfrytëzimin e pushimit të lehonisë në kohëzgjatje prej nëntë (9) ose dymbëdhjetë (12) muajsh.

Mangësitë e identifikuar janë si në vijim:

- Tri raste të specialistëve të rregullta kishin shkuar në pushim të lehonisë pa vendim nga MSH-ja. Në mungesë të vendimit të pushimit të lehonisë, specialistët nuk kanë mundur t'i dorëzojnë dokumentet për të përfituar të drejtën e pushimit me pagesë edhe për tre (3) muajt tjerë nga Qeveria;
- Një specializante ishte paguar nëntë muaj nga MSH-ja (tre muaj më shumë) me 70% të pagës bazë, duke mos i aplikuar ndalesën e pushimit të lehonisë, ndalesën e shujtës dhe shtesës për Covid 19. Po ashtu, edhe në dy raste tjera shujta dhe shtesa për Covid 19 nuk i ishte ndaluar specialistëve që ishin në pushim të lehonisë; dhe
- Ministri me datë 09.03.2022 kishte nxjerrë vendim për pagesën e dy (2) kujdestarive obligative në muaj për specialistët dhe që pagesa duhet të aplikohet në mënyrë retroaktive nga muaji Janar 2022. Ne kemi vërejtur që në katër (4) raste janë paguar më shumë se dy kujdestari për disa muaj. Në listat e pranuar nga SHSKUK kishte pagesa deri në katër kujdestari. Vlera e gabimit ishte 5,855€.

Menaxhimi i dobët ishte rezultat i mungesës së kontrolleve për specialistët nga ana e zyrtarëve përgjegjës të ministrisë. Pas shqyrtimit nga ekipi i auditimit të gabimeve dhe tejkalimeve në pagesa, zyrtarët përgjegjës kanë filluar të aplikojnë ndalesat në paga nga viti 2023.

Ndikimi Mos nxjerrja e vendimeve të pushimeve të lehonisë, pamundëson kompensimin e specializanteve për tre muaj nga qeveria. Në anën tjetër kompensimi jo i duhur i pushimit të lehonisë, kujdestarive si dhe dhënia e shtesave gjatë pushimit të lehonisë ndikon në dëmtimin e buxhetit të Ministrisë.

Rekomandimi B1 Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar monitorim të vazhdueshëm të punonjësve/specializantëve ashtu siç parashihet me aktet ligjore. Duhet të nxirren vendimet e pushimeve të lehonisë në mënyrë që specializanteve mos t'iu mohohet e drejta e kompenzimit të shtesave nga Qeveria. Në rastet e tejkalimeve duhet të aplikohet ndalesa në pagë për të korigjuar dhe evituar dëmtimin e buxhetit për vlerën e tejkaluar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2022 ishte 32,769,259€, prej tyre ishin shpenzuar 17,970,476€, ose 55%. Këto shpenzime kanë të bëjnë kryesisht me blerjen e barnave, paisjeve mjekësore, mirëmbajtje dhe shpenzime të tjera.

Çështja A1 - Mangësi në proceset e prokurimit

Gjetja

Proceset e prokurimit publik duhet të zhvillohen në pajtim me kërkesat e LPP-së, udhëzuesit e prokurimit, kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Në identifikua se:

- Në aktivitetin e ri-tenderimit "Furnizim me dokumente shëndetësore-receta për institucionet shëndetësore" anëtar i komisionit për vlerësimin e tenderit ishte caktuar zyrtari i cili kishte përgatitur specifikat. Kjo është në kundërshtim me nenin 62 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit (RrUOP) të ndarja e detyrave pika 62.3, paragrafi 4. Ky aktivitet kishte filluar me 08.03.2021 dhe kishte rezultuar me kontratë me 30.09.2022.

Po ashtu, në të njëjtin aktivitet të prokurimit ishte krijuar konfuzion te Operatorët Ekonomik (OE) në lidhje me çmimin që duhet ofertuar pas pikës dhjetore. Në fillim në dosje të tenderit ishte kërkuar që çmimet të jenë me dy shifra pas pikës dhjetore, më vonë me katër, pastaj në fund një pjesë e artikujve me dy e pjesa tjetër me katër. Të gjitha këto ndryshime kishin ardhur pas kërkesave të OE si rezultat i specifikimeve që ishin bërë në dosje të tenderit; dhe

- Në procedurën e prokurimit "Blerja e paisjeve medicinale për DSHB" (vlera e kontratës 32,340€) mungon vendimi nga ZKA për caktimin e menaxherit të kontratës, siç kërkohet me nenin 61.15 të RrUOP-së.

Ndarja jo e duhur e detyrave, mungesa e analizave gjatë përgatitjes së specifikave dhe mungesa e vendimit nga ZKA për caktimin e menaxherit të kontratës tregojnë një kujdes jo të duhur të akterëve të involvuar në mbarëvajtjen e proceseve të prokurimit.

Ndikimi

Ndarja jo e duhur e detyrave, konfuzioni rreth aplikimit të çmimeve pas pikës dhjetore dhe mungesa e vendimit për menaxher të kontratës tregon se kontrollet ishin jo efektive në proceset e prokurimit. Aprovimet për ndryshimet në çmime pas presjes dhjetore kanë ndikuar që t'i bëjë konfuz OE dhe duke shkaktuar ankesa gjë që ka rezultuar në stërzgjatje të procesit përderisa QKMF-të dhe institucionet tjera kanë mbetur pa furnizim, të njëjtat kanë përdorur procedura alternative të furnizimit.

Rekomandimi A1 Ministri duhet të siguroj që ndarja e detyrave dhe dosja e tenderit të përgatitet në mënyrë të tillë që të mos ketë nevojë të ndryshohen kërkesat gjatë procesit, me propozime të ofertuesve. Po ashtu, vendimet për menaxher të kontratës duhet të autorizohen nga ZKA-së.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mangësi në procedimin e pagesave

Gjetja Rregulla Financiare nr. 01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se fillimisht duhet të procedohet zotimi i mjeteve, lëshohet urdhër blerja, dhe pas pranimit të mallit bëhet raporti i pranimit, si dhe pranohet fatura.

Ne identifikuam tri raste/pagesa, ku zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimit të shërbimeve/faturës (vonesat në zotime ishin nga një deri në pesë muaj). Këto shërbime ishin për mirëmbajtje të teknologjisë informative dhe shfrytëzim i automjeteve me qira. Totali i këtyre pagesave ishte 26,829€.

Kjo ka ndodhur për shkak të praktikës jo adekuate për të zbatuar procedurat ligjore për shpenzimin e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës. Mirëpo, sipas ZKF-së për disa shërbime tjera specifike kjo mund shkaktoj pengesë në efikasitetin e operimit.

Ndikimi Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave, mund të ndikojë që ministria mos t'i kryej obligimet e faturuara me kohë, rrjedhimisht rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkojë zbatimin e procedurave, duke filluar nga iniciimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,894,880€, prej tyre ishin shpenzuar 3,035,568€. Këto kanë të bëjnë me zgjerimin e infrastrukturës për Sistemin Informativ Shëndetësor (SISH), paisje medicinale, projektin emergjent COVID-19 për Kosovën, etj.

Çështja A3 - Mos konfiskimi i sigurimit të ekzekutimit

Gjetja

Autoriteti Kontraktues (AK) në përputhje me pikën 30.8 të RrUOPP, do të konfiskoj sigurimin e ekzekutimit në rast të shkeljes së kontratës së nënshkruar nga OE, e cila i ka shkaktuar dëme materiale dhe kur AK duhet të shkaktoj shpenzime shtesë për përfundimin e kontratës së tillë.

Në kontratën "Furnizim me pajisje të IT për nevoja të MSh-së" në vlerë prej 10,780€, pas nënshkrimit të kontratës, OE ka dështuar t'i përmbushë kushtet kontraktuale. Pas kësaj shtate MSH ka njoftuar me shkrim OE, për shkëputjen e kontratës, por nuk ka bërë konfiskimin e sigurimit të ekzekutimit (10%) që ishte valid për këtë periudhë në emër të mospërmbushjes së kontratës. Kërkesa për konfiskimin e sigurisë ishte bërë vetëm një (1) ditë para skadimit të afatit.

Kjo kishte ndodhur nga pakujdesia për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës dhe përcjelljes së procesit të tërheqjes së sigurimit të ekzekutimit në afatin ligjor.

Ndikimi

Anashkalimi i kërkesave ligjore për menaxhimin e kontratave mund të ketë ndikim realizimin e projekteve, duke i shkaktuar dëme financiare Ministrisë dhe dështim në dhënien e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Rekomandimi A3

Ministri duhet të sigurohet përmes menaxherëve përkatës se në rastet kur dështon përmbushja e kontratës nga ana e OE pa ndonjë justifikim të bazuar të aplikohen masat e parapara ndëshkuese sepse këto devijime parandalojnë në arritjen e objektivave të synuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Klasifikimi jo adekuat shpenzimeve**Gjetja**

Sipas nenit 18, pikës 3 të rregullores financiare nr. 01/2013-shpenzimi i parasë publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate ekonomike, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë të regjistruara në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Ne identifikuam që gjatë vitit 2022 Ministria ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 90,040€ në kategori ekonomike jo adekuate, të cilat janë të paraqitura në vijim:

- Furnizimi me frigorifer dhe shtretër mjekësorë në vlerë prej 32,340€ ishte buxhetuar dhe paguar nga kategoria e investimeve kapitale. Vlera prej 16,500€ i takon kategorisë nga e cila janë paguar, ndërsa pjesa tjetër prej 15,840€ janë pajse mjekësore nën 1,000€ dhe të njëjtat i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime; dhe
- Blerja e pajisjeve laboratorike në vlerë prej 99,900€ ishte buxhetuar dhe paguar nga kategoria e investimeve kapitale (klauzola e investime). Prej tyre vetëm 25,790€ i takojnë investimeve kapitale, ndërsa pjesa prej 74,200€ i takon kategorisë së mallra dhe shërbime, sepse janë pajse nën 1,000€.

Këto keqklasifikime në pagesa kishin ndodhur si pasojë e planifikimit të gabuar në ndarjet me ligjin e buxhetit.

Ndikimi

Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të MSH-së, duke mbivlerësuar/nënvlerësuar kategoritë përkatëse ekonomike.

Rekomandimi C1

Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 11,847,205€, pasurive jokapitale është 1,243,299€, si dhe e stoqeve 6,290,302€.

Çështja B2 - Dobësi në regjistrin kontabël të pasurive

Gjetja

Sipas nenit 6, pika 3 të Rregullores së MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa ajo jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin "e-pasuria". Kurse neni 5 përcakton klasifikimin që duhet aplikuar për regjistrimin e pasurive, dhe neni 22 i të njejtës rregullore përcakton normën e zhvleresimit.

Në PFV kemi nënvlerësim të pasurisë për 4,304€ (pasuritë e mbivlerësuara ishin për 28,020€, ndërsa të nënvlerësuara për 32,324€).

Informatat në detaje mund të shihen në vijim:

- Te neni 19, Raporti për pasuritë jofinanciare - vërehet se në PFV kishte mbivlerësim të pasurisë jo kapitale për 28,020€. Kjo ishte rezultat i përfshirjes në raportim edhe të disa pasurive nën 1,000€ që i takonin blerjeve të vitit 2023 (kjo kishte ndodhur te administrata e MSH-së, dhe AKPPM si rezultat ndryshimet e aplikuar në sistemin e-pasuria);
- Furnizimi me 92 komoda medicinale për DSHB, në vlerë prej 17,655€ nuk ishte regjistruar në sistemin e-Pasuria;
- Furnizimi me kompjutera, të pranuar në gusht 2022 në vlerë prej 14,669€ nuk ishte regjistruar në regjistrin e-pasuria, e si të tilla nuk figuronin as në regjistrin e stoqeve; dhe
- Paisjet speciale mjekësore në vlerë prej 65,330€ ishin klasifikuar me normën jo adekuate të zhvlersimit.

Dobësitë në regjistrin kontabël të pasurive kanë ndodhur për shkak të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme, për sa i përket fushës së pasurive dhe mos komunikimit të duhur në mes të njësive vartëse në kuadër të MSH-së.

Ndikimi

Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë të pasurive dhe raportimi jo i duhur i tyre pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi pasuritë. Si rrjedhojë e këtyre mangësive kemi nënvlerësim të pasurive duke rezultuar në prezantim jo të drejtë të tyre në pasqyrat financiare.

Rekomandimi B2 Ministri duhet të sigurojë se të gjitha njësitë brenda MSH-së bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarin e pasurisë në mënyrë që të ketë një regjistër të plotë dhe të saktë të pasurive. Po ashtu, duhet shtuar kujdesi gjatë procesit të regjistrimit të pasurive dhe gabimet e evidentuara në regjistrin e pasurive duhet të korrigjohen në mënyrë që vlera e pasurive të jetë reale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.5 Të arkëtueshmet

MSH në PFV-të e vitit 2022 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 973,457€, e cila ka pësuar rritje nga viti paraprak për 93,995€. Këto LL/A kanë të bëjnë me vlerat e prezantuara nga MSH, QKTGJK, dhe Inspektoriati Shëndetësor Farmaceutik.

Çështja A4 - Mbivlerësimi i llogarive të arkëtueshme në PFV

Gjetja Sipas rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, neni 6- organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare.

Vlera e prezantuar llogarive të arkëtueshme në PFV ishte 973,457€, ndërsa sipas raporteve individuale ishte 935,656€. Kjo diferenc ishte gjatë konsolidimit të të arkëtueshmeve në mes njësisë qendrore dhe njësisive vartëse, ku nga Programi i Inspektoriatit Farmaceutik kishte dyfishim të LL/A. Si rezultat i kësaj të arkëtueshmet ishin të mbivlerësuara për 37,801€.

Shpalosjet jo të sakta të informatave në PFV tregojnë se kontrollet gjatë procesit të konsolidimit të të arkëtueshmeve nuk janë mjaftueshëm efektive për shkak të një kordinimi jo shumë të mire në mes njësisive vartëse dhe administratës qendrore.

Ndikimi Prezantimi në vlera jo të sakta ndikon në mbivlerësimin të LLA dhe reflekton në pamje jo të drejtë të PFV-ve duke mos informuar drejtë palët e interesit.

Rekomandimi A4 Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave një koordinim më efektiv në mes njësisive (programeve) me qëllim që gabimet e tilla të mos përsëriten gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të vitit 2023. Po ashtu, Pasqyrat financiare para se të dorëzohen në Thesar duhet t'i nënshtrohen një rishikimi dhe kontrolli të detajuar nga ana e menaxhmentit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Burimet e fondeve	60,403,320	54,575,459	35,744,066	62,711,491	51,357,239
Grante Qeveritare – Buxheti	34,746,320	31,809,633	28,893,431	35,071,104	26,546,379
Financimi përmes huamarrjes	22,047,000	11,957,679	4,614,822	18,287,772	13,315,828
Financimi përmes huamarrjes – klauzola e investimeve	3,610,000	3,610,000	1,625,114	7,112,780	8,720,043
Te hyrat nga AKP-ja	0	0	0	0	1,348,237
Donacionet vendore	0	360,170	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	6,837,977	610,700	2,239,835	1,426,752

Buxheti final është më i ulët se buxheti fillestar për 5,827,861 €. Ky zvogëlim është rezultat i mos shpenzimit të buxhetit në kategoritë ekonomike në mallra dhe shërbime, si dhe në investime kapitale.

Realizimi i ulët i projekteve të planifikuara kapitale dhe jo kapitale ishte kryesisht si rezultat i ankesave të operatorëve në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Mos shqyrtimi i ankesave për shkak të mungesës së Bordit të OSHP-së dhe inflacioni (tërheqja e njëanshme e OE) gjatë vitit 2022 kishin ndikuar në nivelin e realizimit të projekteve dhe vonesën e tyre.

Gjithashtu, Kredia nga Banka CEB të cilën Qeveria e Kosovës e kishte huazuar për blerjen e vaksinave, të cilat kishin kushtuar më lirë sesa planifikimi kishte ndikuar në nivelin e ulët të shpenzimeve.

Në vitin 2022 MSH ka shpenzuar 65% të buxhetit final ose 35,744,066€ me një rritje 11% në krahasim me vitin 2021. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të pakënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	60,403,320	54,575,459	35,744,066	62,711,491	51,357,239
Pagat dhe mëditjet	9,245,123	11,695,067	10,776,522	11,508,451	8,222,716
Mallrat dhe shërbimet	38,054,044	32,769,259	17,970,476	34,270,481	27,097,654
Komunalitë	227,348	232,348	182,602	199,977	140,115
Subvencionet dhe transferet	2,813,805	3,983,905	3,778,897	4,748,974	1,731,449
Investimet Kapitale	10,063,000	5,894,880	3,035,569	11,983,609	14,165,306

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,437,944€, me vendime të qeverisë. Rritja ishte bërë për pagesën shtesë prej 10% (por jo më pak se 60€) për punonjësit shëndetësorë të sektorit publik dhe mjetet janë siguruar nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike. Pjesa tjetër është ndarë për nën programin e aftësimin specialistik dhe EVM, si dhe për mbulimin e mungesës së mjeteve për paga dhe mëditje. Buxheti final I kësaj kategorie ishte shpenzuar 92%;
- Buxhetit final në mallra dhe shërbime ishte zvogëluar për 5,284,785€ në krahasim me buxhetin fillestar, me vendime të qeverisë. Shpenzimet ishin realizuar vetëm 55% e buxhetit final dhe kjo është rezultat i mos realizimit të projekteve të planifikuara që kanë të bëjnë me materiale laboratorike për COVID 19, furnizime me barna dhe pajisje mjekësore, si dhe projekte të tjera; Po ashtu, janë trajtuar procedurat e prokurimit dhe mangësitë të cilat janë hasur gjatë vlerësimeve të tenderit. Sipas raportit të kontratave të nënshkruara 107 procedura janë përfunduar gjatë vitit 2022, ku vetëm dy nga to i takonin projekteve kapitale, ndërsa pjesa tjetër i takonin mallrave dhe shërbimeve. Nëntë (9) nga këto procedura janë anuluar në faza të ndryshme të procesit, me raste edhe pas nënshkrimit të kontratës. Këto anulime të procedurave ishin kryesisht pas vonesave të shqyrtimit të ankesave të operatorëve ekonomik nga OSHP-ja, me vendime të OSHP-së, tërheqjes së OE pas inflacionit, si dhe dy raste me vendim të ZKA-së;
- Buxheti final për komunalitë ishte rritur me 5,000 €. Kjo shumë u alokua me vendim të qeverisë për mbulimin e shpenzimeve komunale. Megjithëse, mjetet nga buxheti final ishin shpenzuar 78%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere duke krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,170,100€, me vendim të qeverisë për vazhdimin e përkrahjes edhe për pjesën e mbetur të vitit për financimin e specialistëve, sepse fillimisht ishte ndarë buxheti vetëm për tetë muaj për pagesën e tyre, këto shpenzime ishin 95% nga buxheti final; dhe

- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 4,168,120€. Shpenzimet e krahasuar me buxhetin final ishin realizuar vetëm 51%. Kjo ishte si pasojë e planifikimeve me ligj të buxhetit për projekte kapitale, për QKMF Ferizaj në vlerë 2.6 milion euro, paisje mjekësore për IKSHPK 360,000€. Inflacioni I vitit 2022 ka ndikuar në mos realizimin e implementimit të projekteve kapitale dhe tërheqje të OE në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat e realizuara nga Ministria e Shëndetësisë në 2022 ishin në vlerë 5,842,047€. Ato kanë të bëjnë me gjobat nga inspektorati, licenca nga aktivitetet individuale dhe të lira, licenca për produkte medicinale, banderolat, participimet, shtija e shërbimeve dhe inspektimi higjienik sanitar. Ministria nuk ka marrëveshje për shfrytëzimin e të hyrave të realizuara, të hyrat e arkëtuara derdhen në buxhetin e Kosovës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
Totali i të hyrave	5,877,003	5,877,003	5,842,047	5,301,986	4,197,908
Të hyrat jo tatimore	5,877,003	5,877,003	5,836,038	5,296,048	4,195,412
Të hyrat tjera	0	0	6,009	5,937	2,496

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2021 të MSH-së ka rezultuar në nëntë (9) rekomandime kryesore. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Ministria, ka dorëzuar Raportet e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve sipas kërkesave të dalura nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Poashtu, raporti i auditimit të vitit 2021 ishte shqyrtuar edhe në Komisionin për Mbikqyrjen e Financave Publike të Kuvendit. Ky komision kishte dhënë një rekomandim për MSH-në, i cili kishte të bënte me adresimin dhe implementimin e rekomandimeve të ZKA-së. Ky rekomandim pjesërisht ishte zbatuar siç mund të shihet në tabelën e rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar, dy (2) nuk janë zbatuar ende dhe një (1) rekomandim është pjesërisht i zbatuar, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël. Një bashkëpunim më efektiv me Ministrinë e Financave do të lehtësonte gjetjen e zgjidhjeve, në mënyrë që të shmangen këto devijime.	Edhe këtë vit kemi keqklasifikim të shpenzimeve, mirëpo vlera e tyre këtë vit është më e ulët në krahasim me vitin paraprak.	Pjesërisht i zbatuar
2.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave një kordinim më efektiv në mes drejtorive në raportimin e faturave të papaguara me qëllim që në PFV të shpaloset vlera e saktë e obligimeve të papaguara.	Faturat e papaguara janë prezantuar si obligime.	I zbatuar
3.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar monitorim të vazhdueshëm të punonjësve/specializantëve ashtu siç parashihet me aktet ligjore. Në rastet e tejkalimeve duhet të aplikohet ndalesa në pagë për të korigjuar dhe evituar dëmtimin e buxhetit për vlerën e tejkaluar.	Edhe gjatë këtij viti kemi hasur raste të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave se çdo faturë e pranuar dhe e paguar nga ana e Ministrisë duhet të jetë në përputhje me kërkesat e ligjit të ATK-së. Po ashtu, Ministria duhet të rishikoj nëse normat e aplikuara të TVSH-së për këto fatura ishin adekuate dhe nëse ka devijime të ndërmerr veprime për korigjimin e tyre.	Departamenti i financave është siguruar çdo faturë e pranuar dhe e paguar nga ana e Ministrisë është në përputhje me kërkesat e ligjit të ATK-së.	I zbatuar
5.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurojë se vlerësimi i ofertave përfundohet brenda afateve të përcaktuara duke mundësuar që furnizimet të merren në kohën e paraparë. Në rastet kur bëhet fjalë për procedura komplekse duhet të shqyrtohen zgjidhjet e nevojshme për të përshpejtuar procesin e vlerësimit.	Janë ndërmarrë veprimet e duhura për adresimin e këtij rekomandimi.	I zbatuar
6.	Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë se të gjitha njësitë brenda MSH-së bashkëpunojnë efektivisht	Edhe gjatë këtij viti kemi hasur në dobësi	Nuk ka filluar zbatimin

		me zyrtarin e pasurisë në mënyrë që të ketë një regjistër të plotë dhe të saktë të pasurive. Po ashtu, duhet shtuar kujdesi gjatë procesit të regjistrimit të pasurive dhe gabimet e evidentuara në regjistrin e pasurive duhet të korrigjohen në mënyrë që vlera e pasurive të jetë reale.	në fushën e pasurisë.	
7.	Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë se pas inventarizimit duhet të bëhet harmonizimi me regjistrin e pasurive për të korrigjuar gabimet e mundshme në regjistrin e pasurive.	Janë ndërmarrë hapat e duhur për implementimin e këtij rekomandimi	I zbatuar
8.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri duhet të sigurojë që marrëveshja e arritur fillon të zbatohet dhe në të gjitha rastet kur inkasimi nuk kryhet në kohën e duhur lëndët duhet të procedohen te përmbaruesi në mënyrë që të hyrat të inkasohen sa më parë.	Ka filluar dërgimi i lëndëve tek përmbaruesi.	I zbatuar
9.	Auditimi i Brendshëm	Ministri duhet të sigurojë se Komiteti i Auditimit mban takimet në mënyrë që puna e NJAB të monitorohet dhe të jetë e pavarur dhe efektive përmes zbatimit të rekomandimeve.	Janë mbajtur takimet sipas kërkesave ligjore	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Kreshnike Haziri-Bublica, Udhëheqëse e ekipit



Shefkije Beka, Anëtare e ekipit



Leonora Hasani, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DREKTORIA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO DIREKTORIALI E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO DIREKTORIALI E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
23.05.2023			
Nr. Org. / Org. Unit	Shif. Klasif. Class. Code	Nr. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve No. Pages
03	47	759	1



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVSTVA-MINISTRY OF HEALTH			
Nr. Prot. Prot. No.	21-3136		
Nr. i faqeve No. pages	-28-		
Data Date:	22.05.2023		
Prishtinë / a			

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kemi pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **Ministritë së Shëndetësisë**, për vitin 2022 - (në tekstin e mëtejshëm "DRAFT-RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRITË SË SHËNDETËSISË PËR VITIN 2022");
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Dr.Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm

Data: 22.05.2023,



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.